



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 447/6 Prot.

Tiranë, më 10.10.2023

V E N D I M

Nr. 198, Datë 10.10.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 49, datë 28.03.2023, të S.S kundër Bashkisë Fier në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*¹” dhe kundër Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim të fëmijëve të tij: V dhe M.S për shkak të “*bindjes së tij politike*”, “*përkatësisë prindërore*²” dhe “*çdo shkak tjetër*³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Në vijim të ankesës të mëparshme nr. 219, datë 22.11.2021, drejtuar KMD-së, detyrohem të paraqes përsëri ankesë, pasi diskriminimi ndaj personit tim dhe familjes sime, pas ankesës së parë pranë KMD-së, jo vetëm që nuk është ndërprerë ose minimizuar, por ka vazhduar në formën më të rëndë: viktimizim, shtrirja e këtij diskriminimi dhe tek fëmijët, në shkollë.*”

1. Pas vendimit nr. 108, datë 07.06.2022 të KMD-së, në zbatim të detyrave të këtij vendimi, më datë 15.07.2022, me shkresën nr. 6175, datë 14.07.2022, jam njoftuar se në datë 15.07.2022, do

¹ Referuar kopjes së Kartës së Anëtarësisë nr. 5-993 të lëshuar nga Partia Republikane e Shqipërisë, Dega Fier, rezulton se ankesi S.S është pranuar si anëtar i këtij subjekti politik në datën 10.10.1995. Referuar Vërtetimin nr. 15, datë 18.05.2022, të lëshuar nga Partia Republikane, Dega Fier, rezulton që ankesi S.S është anëtar i kësaj force politike dhe aktivist i këtij subjekti.

² Referuar certifikatës familjare të lëshuar nga Njësia Administrative Cakran, datë 17.11.2020, rezulton se S.S është babai i dy fëmijëve: V.S dhe M.S.

³ Për shkak të ankesës së bërë pranë KMD-së në datë 22.11.2021, kundër Bashkisë Fier.

të vinte pranë banesës sime të djegur nga zjarri i datës 13.12.2020, një komision i ngritur nga Bashkia Fier, për të bërë konstatimin e dëmeve. Me datë 15.07.2022 sipas njoftimit, vjen një komision pranë banesës sime të djegur. Prezent kam qenë unë dhe znj. L.S, e cila banonte në një pjesë të këtij objekti. Komisioni na pyeti mua dhe L.S për dëmet në orendi dhe pajisje, për të cilat mbajti një procesverbal, i nënshkruar me dakordësi nga unë dhe nga L.S dhe një nga anëtarët e komisionit. Me datë 28.07.2022 kam bërë një kërkesë pranë Bashkisë Fier, në të cilën kam kërkuar kopje të akt-konstatimit të datës 15.07.2022. Me shkresën nr. 6507/1, datë 09.08.2022, më dërguan një kopje procesverbal konstatimi, vetëm me firmat e komisionit, pa firmën time, ku përsëri nuk ishin pasqyruar të gjitha orenditë dhe paisjet, si kundërpeshë e ankesës sime pranë KMD-së. Komisioni kishte pasqyruar më pak se komisioni i mëparshëm, një përqindje shumë herë më e vogël se dëmi i vërtetë. Komisioni i parë nuk bëri konstatimin e të gjitha dëmeve, me pretendimin se duhet të pasqyrojnë aq sa ka mundësi bashkia të zhdëmtoj, ndërsa komisioni i dytë pretendon se ka pasqyruar sa ka parë me sy, në një kohë kur gjurmët e objekteve të dëmtuara, të papasqyruara në këtë akt-konstatim, duken qartë. Këtë akt konstatimi nuk e kam pranuar dhe e kam kundërshtuar me shkresën nr. 6507/2, datë 16.08.2022, duke i kërkuar Bashkisë Fier që të ndalë diskriminimin ndaj familjes sime.

2. Ashtu si kam cituar dhe më sipër, jam prind i dy fëmijëve të mitur, të cilët kanë qenë nxënës të shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa” Fier, ku nëndrejtoreshë është bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier. Të dy fëmijët kanë qenë nxënës me përparim dhe sjellje të shkëlqyer. Të dy kanë qenë përfaqësues të klasave të tyre në senatin e shkollës. Me datë 13.10.2021 është mbledhur senati i shkollës dhe ka zgjedhur djalin tim V.S, nxënës i klasës së IX-të, kryesensor të shkollës, veprim për të cilin jam informuar nga fëmijët dhe faqja zyrtare e facebook të shkollës “Andon Xoxa”. Në muajin janar 2022 vërej tek fëmijët rënie të dëshirës për shkollën dhe probleme shëndetësore, sidomos te vajza, M.S, klasa VII-të, e cila manifestonte shpesh të menjëhershme të ekuilibrit, ndërsa djali u bë nevrrik. Në bisedë me fëmijët ata shprehën pakënaqësi për disa mësues dhe drejtues të shkollës, se i diferencenin si në komunikim gjatë procesit mësimor, ashtu edhe në vlerësim. Jam interesuar në shkollë me mësues dhe drejtues dhe më është thënë prej tyre se çdo veprim e bëjmë për të mirën e fëmijëve.

Gjendja shëndetësore e vajzës sa vinte dhe rëndohej. Filluam të merreshim me shëndetin e vajzës sa në Fier, sa në Tiranë. Konkluzioni përfundimtar i mjekëve ishte se një nga shkaqet e kësaj diagnoze ishte stresi.

Me datë 04.05.2022 kur kthehem nga puna pamë se djali nuk kishte ardhur në shtëpi. Pyetëm shokët dhe na thanë se V.S kishte bërë një orë mësim dhe ishte larguar nga mësimi me një shok të klasës së tij. Për largimin e djalit nga mësimi që në orën e dytë nuk jemi njoftuar nga shkolla. Me ndihmën e shokëve dhe prindërve të fëmijës tjetër me të cilin ishte larguar djali im, bëj të mundur gjetjen e djalit në Tiranë, në një gjendje të rënduar psikologjike. Të nesërmen në mëngjes djali më tha se nuk dëshironte të shkonte më në atë shkollë, pasi nuk ndihej mirë.

Me datë 05.05.2022, nisur nga gjendja e rënduar e djalit, nuk e nisa në shkollë, e lë në shtëpi nën kujdesin e bashkëshortes dhe shkoj në drejtorinë e shkollës, ku kërkoj nga titullarja e shkollës një

takim me drejtuesit dhe stafin mësimor, për të gjetur shkaqet që detyruan fëmijën të largohet nga shkolla.

I drejtohem stafit drejtues dhe mësimor me pyetjen: “Cilat janë arsyet që detyruan senatorin e shkollës të bënte këtë veprim?”.

Në moment, titullarja e shkollës znj. A.P më thotë se V.S nuk është më senator i shkollës, pasi është hequr që në muajin dhjetor 2021.

Sqaroj se deri në këtë moment ne si prindër nuk ishim të informuar, as nga djali as nga shkolla për heqjen e djalit si senator i shkollës nga drejtoria e shkollës.

Në komunikim me drejtoreshën e shkollës, shprehem se nuk jam informuar për këtë veprim të drejtorisë së shkollës, as nga ju dhe as nga djali. Pra djali e ka mbajtur brengë në vetvete, mendoj se pikërisht ky ka qenë shkaku.

Pas kësaj bisede disa mësues u acaruan duke më fyer me shprehjen: “Veprimet e V.S janë pasqyrë e prindit”, në një kohë që po nga ata mësues, gjatë gjithë kohës, fëmijët e mi i kishin vlerësuar shumë mirë në sjellje dhe përparim, po ashtu edhe unë si prind i përkushtuar.

Me dëshirën e djalit, i detyruar nga situata, jashtë mundësive financiare, kam kërkuar shpërnguljen nga ajo shkollë dhe regjistrimin në një shkollë private. Për shpërnguljen jam sorollatur si nga shkolla dhe nga ZVAP Fier.

Në këto rrethana kam kërkuar nëpërmjet një kërkesë me shkrim, nga drejtoria e shkollës, të më jepeshin, shkaqet dhe procedurat që janë ndjekur nga ana e shkollës për shkarkimin e djalit tim si senator i shkollës. Nuk mu pranua kërkesa, madje mu ndalua të hyja në shkollë pa lejen e drejtoreshës së shkollës. Detyrohem që komunikimin ta bëj nëpërmjet shërbimit postar dhe adresës së e-mail-it të shkollës.

Njëkohësisht kam kërkuar që të më vihen zyrtarisht në dispozicion testet dhe detyrat e portofolit (origjinalet) për të bërë argumentimin e notave për të dy fëmijët. Drejtoria e shkollës i ka anashkaluar veprimet e saj, duke dhënë përgjigje të pakuptimta. Nuk na ka vënë në dispozicion testet dhe detyrat e portofolit (origjinale) të fëmijëve. Nëpërmjet adresës së emailit i kam kërkuar Ministres së Arsimit, që të ngrejë një komision për të verifikuar dhe argumentuar notat e fëmijëve, si dhe të më bëjë të mundur që të më vihen në dispozicion nga shkolla testet dhe detyrat e portofolit (origjinale) të fëmijëve. Deri më sot asnjë përgjigje.

Për t'i anashkaluar problemit, është sajuar një ankesë për drejtoreshën e shkollës, drejtuar DPAP Tiranë, pretenduar se është bërë nga ime. Problematikat që janë ngritur në këtë ankesë i di vetë drejtoresha dhe stafi i shkollës. Sqaroj se kjo ankesë, nuk ishte e nënshkruar nga personi im dhe nuk kishte adresën time të banimit. Për këtë ankesë, DPAP Tiranë më kthen mua një përgjigje, kur unë nuk kisha bërë ankesë.

Largimi i djalit tim si kryesentor i shkollës nga drejtoria e shkollës, si dhe trajtimi ndryshe në komunikim dhe vlerësim i fëmijëve të mi nga disa mësues, është veprim diskriminues, i cili ka

ndikuar negativisht në personalitetin dhe gjendjen shëndetësore të fëmijëve të mi, pasoja të cilat po vazhdojmë t'i vuajmë të gjithë, familjarisht”.

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit: S.S nga ana e Bashkisë Fier dhe ngritjen e një komisioni me ekspertë përkatës, për të bërë një konstatim real të dëmeve dhe zhdëmtimin e dëmit si e parashikon ligji dhe diskriminimin e V.S dhe M.S⁴ nga ana e Shkollës “Andon Xoxa” Fier.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

⁴ Perfaqësuar ne kete ankese nga S.S, babai i tyre

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 447/1, datë 03.04.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

Nga ana e Bashkisë Fier:

- Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, Fier:

- Kopje të plotë të procedurës së zgjedhjeve të qeverisë së nxënësve, të vitit shkollor 2021-2022 dhe të ndryshimeve, në vijim.
- Informacion, përse nuk është njoftuar prindi për largimin nga shkolla të djalit të tij, në datë 04.05.2022.
- Kopje të procesverbalit të takimit të zhvilluar mes ankuesit dhe stafit të shkollës, në datë 05.05.2022.
- Kopje të plotë të procedurës së transferimit të djalit të ankuesit.
- Informacion mbi arsyet e mosvënies në dispozicion të ankuesit, të testeve dhe detyrave të portofolit të dy fëmijëve të tij.
- Kopje të dëftesës së klasës së VIII-të, të semestrit të I-rë dhe të klasës së IX-të të nxënësit V.S.
- Kopje të dëftesës së klasës së VI-të , të semestrit të I-rë dhe të klasës së VII-të, të nxënëses M.S.

Me shkresën nr. 3507, datë 20.04.2023, Bashkia Fier, informoi Komisionerin se: “Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjit nr. 139/2015, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në përgjigje të shkresës Tuaj, Ju sqarojmë se:

- Ndhima familjeve të prekura nga fatkeqësi të ndryshme jepet në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
- Bazuar në Vendimin nr. 108, datë 07.06.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë u ngrit tjetër Komision për verifikim të fakteve të paraqitura në kërkesën e shtetasit S.S.

- Komisioni pasi bëri njoftim paraprak të palëve të interesuara shkoi në banesën e shtetasit S.S në fshatin Gorishovë të Njësisë Administrative Cakran dhe përpiloi dokumentacionin e nevojshëm për konstatimin e bërë.
- Në vend u plotësua dhe një Procesverbal i pretendimeve të S.S dhe znj. L.S me nënshkrim të tyre.
- Sipas kërkesave të ligjit dhe të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 u plotësua Procesverbali i Konstatimit për vazhdimin e procedurave për dhënie ndihme.
- Për kërkesën në Bashki me nr. 6507, datë 28.07.2022 të S.S i kemi kthyer përgjigje bashkë me dokumentacionin që kërkonte.
- Për kërkesën në Bashki me nr. 6507/2, datë 16.08.2022 i kemi kthyer përgjigje S.S për pretendimet e tij dhe për procedurën e ndjekur.
- Nevojitet të theksojmë se konstatimi kryhet me komision dhe komisioni identifikon dëme të dukshme dhe të matshme”.

Me shkresën nr. 376, datë 26.04.2023, Shkolla 9-vjeçare “Andon Xoxa”, dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

Në përgjigje të parashtrimeve të Bashkisë Fier dhe Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, ankuesi me e-mail-in datë 02.05.2023, informon se: “Lidhur me përgjigjen e Bashkisë Fier: Komisioni i ngritur nga Bashkia Fier, me datë 15.07.2022 në zbatim të detyrave të lëna nga KMD në Vendimin nr.180, datë 06.07.2022, për evidentimin e të gjitha dëmeve të pretenduara nga shtetasi S.S të shkaktuara nga zjarri i rënë në shtëpinë e tij më datë 13.11.2020, jo vetëm nuk bëri evidentimin e plotë të dëmit, por vazhdon diskriminimin, duke u tallur me personin tim.

Komisioni nuk ka evidentuar dëme të dukshme dhe të matshme si: - Numri i dyerve dhe dritareve; - Materiali i dyerve dhe dritareve, pasi disa prej dritareve dhe dera kryesore, janë duralumini, dmth janë të dukshme; - orenditë e kuzhinës, sipërfaqja e çatisë është shënuar 100 m2, kur objekti ka sipërfaqe 150 m2; - kolltukët, krevatet (me skelete hekur); - Muret e rrënuara, mbi 50%, rrjeti elektrik i gjithë shtëpisë, suvatimet e mureve për gjithë shtëpinë, etj, të cilat kanë lënë gjurmë të plota, të dukshme dhe të matshme. Komisioni nuk ka evidentuar orendi, të cilat kanë lënë pjesërisht gjurmë si: krevate druri, dollapë rrobash, kornizat e dritareve, orendi që kanë lënë pjesë metalike, etj.

Lidhur me përgjigjen e Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, informon se: “Pika 1. Me datë 04.05.2022 nuk ka patur aktivitet sportiv për djemtë dhe V.S nuk kishte arsye të shkonte në aktivitet. Sqaroj se kur V.S merrte pjesë në aktivitete sportive, njoftohesha nga mësuesi i edukimit fizik kur nisej dhe kur kthehej.

A i vendoset mungesë nxënësit kur ka aktivitet të organizuar nga vetë shkolla?

Sa vlerë ka mungesa që vendoset në regjistër, kur nxënësi largohet nga mësimi dhe prindi nuk informohet?

Pika 2- Me datë 05.05.2022 kam shkuar në shkollë për t’u informuar se cilat kanë qenë shkaqet, rrethanat që detyruan V.S të arrinte në këtë veprim ekstrem. Në shkollë jo vetëm që nuk u sqarova për pyetjet që bëra në lidhje me veprimin e ndodhur, nuk gjeta as bashkëpunim me stafin, por jam

fyer nga mësuesja L.J, e cila shprehimisht tha: “Veprimet e V.S janë pasqyrë e prindërimit të keq”.

Pika 3- Komunikimi për largimin si senator fëmijës tim, i është bërë në korridorin e shkollës nga nëndrejtoresha e shkollës, znj. I.S, (bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier), e cila e kishte nxjerrë nga ora e gjuhës shqipe me mësuese L.J, ku kjo e fundit, sapo fëmija kishte hyrë në klasë ishte shprehur me fjalët: “Hë, V.S, të hoqën si senator?”, veprim i cili lë të kuptosh se gjithçka është diskutuar midis drejtorisë dhe një grupi mësuesish. Pra, kryesensori i shkollës, është zgjedhur nga senati i shkollës dhe është hequr nga drejtorja!?

Pika 4- Fakti që midis prindit dhe mësueses kujdestare E.P.V ka gjuhë komunikimi, nuk mund të përdoret si argument se mësues të tjerë lëndorë apo dhe drejtues, nuk e kanë bërë fëmijën të ndihet i diferencuar.

Sqaroj se midis veprimeve të tjera diferencuese të dukshme dhe të padukshme nga mësues lëndorë apo drejtues ndaj vajzës sime, M.S përmend: - Dhënia e dëftesës, dokument zyrtar, për mbarimin e klasës së VII-të, viti shkollor 2021-2022, për vajzën time, pa vulën e institucionit, tregon qartë diferencimin e fëmijës nga titullarja e institucionit.

Ndoshta gabimi njerëzor i radhës?! Gabim njerëzor shkarkimi i V.S si kryesensor?! Gabim njerëzor dhënia e fletëshpërnguljes e pavlefshme?! Gabim njerëzor mos regjistrimi i emrit të V.S te lista e Provimeve të Lirimit, lënda Matematikë?!”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 447/2, datë 14.06.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 22.06.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi S.S, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizim datë 19.06.2023, të Bashkisë Fier, z. L.M dhe znj. J.T dhe përfaqësuesve të Shkollës “Andon Xoxa” Fier, znj. A.P, (drejtoresha) dhe znj. J.SH, znj. E.P dhe znj. L.J (mësuese).

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në dhe deklaroi⁵ se: “Prej 9 vitesh fëmijët kanë ndjekur shkollën “Andon Xoxa” dhe marrëdhëniet me shkollën nga unë si prind bashkë me bashkëshorten kanë qenë shumë të mira. Kam kërkuar testet origjinale dhe nuk më janë dhënë, më janë dhënë disa fotokopje dhe një ishte i korrigjuar. Znj. I.S ka disa vite që është nëndrejtoreshë dhe sjellja ka ndryshuar pas ankimit që kam bërë në KMD kundër Bashkisë. Edhe vajza është senatore e shkollës dhe nuk janë thirrur në mbledhje për shkarkimin e kryesensorit. Nuk ka një vendim senati për shkarkimin e djalit, por është bërë tek dera e klasës. Në datë 04.05.2022, sipas mësuesit të edukimit fizik, nuk ka pasur aktivitete dhe drejtorja ka qenë e

⁵ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 19.15 e në vijim.

sinjalizuar që nuk ka aktivitet. Vajza në datë 04.05.2022 ka qenë gjithë ditën në mësim dhe nuk është e vërtetë që ka qenë në aktivitet”.

Gjatë seancës dëgjimore, drejtuesja e shkollës “Andon Xoxa”, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, ndërkohë që dhe mësuesit pjesëmarrës në seancë deklaruan⁶ se: *“Në Udhëzimin nr. 25, datë 02.08.2013, për funksionimin e qeverisë së nxënësve, përcaktohet se senatorët duhet të jenë nga klasa e katërt deri në klasë të tetë. Në shkollë këtë përgjegjësi e mbulon një mësuese që ka një ngarkesë prej katër orësh për koordinimin e qeverisë së nxënësve. Koordinatorja E.P, në muajin tetor 2021 ka zgjedhur V.S si senator, por ka qëndruar vetëm një muaj. Në bazë të mbledhjes së qeverisë së nxënësve, V.S shkarkohet me votim, sepse ishte nxënës i klasës së nëntë. Koordinatorja e ka sqaruar V.S për largimin sepse nuk e përmban udhëzimi që senatori të jetë nga klasa e nëntë dhe nuk pati asnjë kundërshtim/shqetësim nga V.S deri në maj 2022. Nuk ka pasur asnjë ankesë për këtë rast prandaj dhe nuk është marrë asnjë masë për koordinatoren e qeverisë së nxënësve. Nuk është njoftuar prindi që është hequr V.S si senator, pasi nuk është e parashikuar në ligj, por është lajmëruar nxënësi.*

Në datë 04.05.2022, V.S ka ardhur në mësim orën e parë dhe është larguar, mësuesja kujdestare ka qenë me raport mjekësor dhe nuk dinim gjë, kur në orën 14.30 merr në telefon znj. S.S dhe thotë se V.S nuk ka ardhur në shtëpi. Një ditë përpara mësuesja kujdestare e vajzës ka bërë një bisedë me nënën e vajzës dhe i ka kërkuar leje për vajzën sepse i vëllai ka ndeshje. Mungesat V.S i janë vënë në rregjistër.

Znj. I.S është emëruar si nëndrejtoreshë para shtatë vitesh dhe kam marrë dijeni për ankesën e S.S kundër Bashkisë Fier vetëm kur jemi njohur me shkresat e Komisionerit për ankesën që jemi në proces.

- J.Sh. (Mësuese kujdestare zëvendësuese e V.S). Kam komunikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe gjatë gjithë kohës kam pasur marrëdhënie shumë të mira me prindërit. Ditën që V.S është larguar kemi pasur një listë nxënësish që kishin marrë leje dhe kemi telefonuar prindërit dhe meqë një ditë përpara, znj. S.S kishte telefonuar mësuesen kujdestare të vajzës dhe i kishte kërkuar leje për vajzën e mora të mirëqenë që djali do shkonte në aktivitet sportiv. Nga ora e katërt e mësimi kam telefonuar znj. S.S dhe i kam thënë se djali nuk është në shkollë pasi ka shkuar në një aktivitet sportiv. Pavarësisht se nxënësit marrin pjesë në aktivitete ne i vendosim mungesë, por janë mungesa me arsye.*
- E.P. (Mësuese kujdestare e vajzës M.S). Marrëdhëniet me prindërit kanë qenë shumë të mira, të qeta dhe kemi qenë bashkëpunues me njëri-tjetrin. Një ose dy ditë përpara jam njoftuar nga znj. S.S e cila kërkoi leje për vajzën se do shkonte një një aktivitet sportiv të vëllait. Vajza erdhi të nesërmen bashkë me një shoqe A.M dhe mori leje por nuk mbaj mend se sa orë mësim ka bërë. Aktiviteti sportiv është anuluar.*
- L.J. (Mësuese e lëndës gjuhë shqipe). Kam komunikuar me znj. S.S pasi jemi mësuese të së njëjtës lëndë dhe me fëmijët që nga viti 2020 deri me 29.05.2022 që ka ndodhur debati me S.S.*

⁶ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 39.00 e në vijim.

Në datë 05.05.2022 kam qenë prezent në takim si gjithë kolegët e tjerë dhe i jemi përgjigjur pyetjeve të S.S. Situata e tij ka qenë e acaruar dhe nuk është e vërtetë që ka debatuar me mua. S.S në datë 10.05.2022 ka ardhur në drejtorinë e shkollës dhe sa ka hyrë më është drejtuar me fjalë fyese, por nuk i kam kthyer përgjigje. Vajza kishte bërë një detyrë përmbledhëse, siç kisha bërë me të gjithë nxënësit. Duke ditur natyrën emotive të vajzës M.S që ma ka bërë të ditur znj. S.S, jam munduar gjatë gjithë kohës që kam qenë mësuese e saj që ta trajtoj me dashuri dhe kur kam ndarë fletët për nxënësit e tjerë, vajzës nuk ja kam dhënë, sepse nuk kishte dalë mirë. E kam thirrur ditën tjetër dhe duke qenë se znj. S.S është mësuese gjuhe, kam fotografuar testet e fëmijës që mi kishte kërkuar dhe në telefon më ka thënë se më ke vrarë fëmijët, do të të hedh pas prangave. Kam debatuar me prindin sepse nuk e kuptova përse duhej të më drejtohej mua me ato fjalë dhe pa shkak. Kam qenë mësuesja e parë që kam dorëzuar dosjen me punimet e fëmijëve të S.S. Tek një detyrë shtëpie V.S më pyeti përse është quajtur gabim kjo pyetje dhe i kam shpjeguar arsyen. Këtë ia kam shpjeguar dhe me shkrim S.S. Lidhur me shkarkimin e djalit si senator dhe përfshirjes sime sepse ka qenë në orën e gjuhës shqipe dhe e paska marrë nëndrejtoresha, deklaroj se është e pavërtetë dhe unë shumë kohë më pas e kam marrë vesh që nuk është senator”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Fier i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi⁷ se Bashkia ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e Komisionerit dhe çështja është në proces.

Në vijim të seancës dëgjimore, shkolla “Andon Xoxa”, me e-mail-in datë 05.07.2023, informoi Komisionerin si më poshtë: “- Për procedurën e emërimit dhe të ç’emërimit, prindi i nxënësit V.S është informuar nga mësuesja koordinatorë e Qeverisë së Nxënësve, E.P në Drejtorinë e shkollës në prani edhe të psikologut të shkollës. Bëjmë me dije se këto dokumente ruhen nga ana e koordinatorës vetëm për 1 vit mësimor. Prindi dhe nxënësi nuk kanë bërë asnjë ankesë me shkrim ose me gojë në Drejtorinë e shkollës.

- Ditën që nxënësi është larguar nga shkolla, aktiviteti sportiv është anuluar, prandaj nxënësit i është vendosur mungesë edhe pse prindi ka kontaktuar me mësuesen kujdestare për të marrë leje. Aktiviteti është zhvilluar në datën 6 maj 2022, këtë e konfirmon edhe mësuesi i Edukimit Fizik.
- Formulari tip i shpërnguljes së nxënësit, të dhënë nga Drejtoria e shkollës, në të cilin është emërtimi MASR dhe jo MAS, ka qenë i njëjtë edhe me formularin e pranimit nga shkolla jopublike “Flatrat e dijes”, për të cilin S.S nuk ka paraqitur asnjë lloj kontestimi. Formulari i është dhënë sërish prindit të nxënësit me emërtimin MAS.
- Çdo lloj dokumentacioni në lidhje me ecurinë e detyrave me shkrim, i është vënë në dispozicion nga mësuesit e lëndëve dhe për rastet kur prindi ka kërkuar sqarime, i është kthyer përgjigje e plotë sqaruese me shkrim nga mësueset e lëndëve.
- Sqarojmë se nga ana e KMD na kanë ardhur 2 shkresa; njëra me nr. 447/1, datë 03.04.2023 “Njoftim dhe kërkesë për informacion” për të cilën ju kemi dërguar me postë dokumentet e

⁷ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 10.30.

kërkuar, dhe shkresa me nr. 447/4, datë 14.6.2023 “Njoftim për seancë dëgjimore” për të cilën kemi dhënë sqarimet tona në takimin e datës 22.06.2023.

- *Ne si institucion nuk jemi në dijeni se S.S është ankuar pranë Bashkisë Fier.*
- *Shkolla është e depolitizuar dhe në shkollën “Andon Xoxa” nuk ka pasur asnjë rast diskriminimi për bindje e përkatësi politike”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit S.S kundër Bashkisë Fier.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

S.S me ankesën nr. 219, datë 22.11.2021, drejtuar KMD-së, ka pretenduar diskriminim lidhur me mosdhënia e ndihmës financiare për banesën e tij të djegur, mospërfshirjen e të gjitha orendive të shkatërruara dhe materialeve ndërtimore të banesës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të dëmeve dhe mosinteresimi i zyrës së mbrojtjes civile për gjendjen të cilën familja e tij ndodhej, pas djegies së banesës nga ana e Bashkisë Fier.

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të ankesës së mësipërme, për të cilën Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur me Vendimin nr. 108, datë 07.06.2022, në të cilin ka vendosur: “1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të “bindjes politike” të S.S, nga ana Bashkisë Fier. 2. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Fier të marrë të gjitha masat për ngritjen e një komisioni tjetër që të kryejë edhe një herë vlerësimin e banesës së shkatërruar nga djegia, në bashkëpunim me të dy familjet që kanë banuar në të. 3. Komisioni i Vlerësimit të Dëmit të marrë të gjitha masat e nevojshme për verifikimin e të gjitha pretendimeve të S.S, lidhur me objektet, orenditë dhe materialet ndërtimore të banesës që rezultojnë të papërfshira në procesverbalin e konstatimit të dëmit të datës 24.11.2020”.

Vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga Bashkia Fier në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr. 1543 datë 13.06.2023 ka vendosur: “Pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimin e Vendimit nr. 108, datë 07.06.2022 të Komisionerit”. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kundërshtuar dhe çështja është në proces.

Për sa më sipër, Komisioneri, bazuar në nenin 33, pika 4/c e LMD-së, të ndryshuar, i cili përcakton se: “Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”, gjykon se ky pretendim i ankuesit për diskriminim nga ana e Bashkisë Fier, nuk mund të pranohet për shqyrtim.

B. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të V dhe M.S, të përfaqësuar nga S.S, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, Fier.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga këqyrja e dokumentacionit, deklarimeve të palëve dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezultoi se:

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se në vitin shkollor 2021-2022, V.S ishte nxënës në klasën e 9-të dhe M.S ishte nxënës në klasën e 7-të.

Në datë 13.10.2021 në shkollën “Andon Xoxa” është bërë mbledhja për zgjedhjen e qeverisë së nxënësve dhe të kryetarit. Në këtë mbledhje si kryetar i qeverisë së nxënësve është zgjedhur V.S, nxënës i klasës së 9-të. Pas rreth një muaji, V.S është njoftuar për shkarkimin e tij si kryetar i qeverisë së nxënësve, pasi ishte nxënës i klasës së 9-të. Referuar deklaratimit të drejtores së shkollës, gjatë seancës dëgjimore, emërimi dhe shkarkimi i është njoftuar nxënësit nga ana e koordinatores së qeverisë së nxënësve, znj. E.P, por nuk ka asnjë provë për ta vërtetuar këtë.

Në datë 04.05.2022, V.S është paraqitur në shkollë në orën e parë dhe më pas është larguar nga mësimi për të ndjekur një aktivitet sportiv, për të cilën i janë vendosur dhe mungesa në regjistrin e klasës. Referuar deklaratave të bëra nga palët gjatë seancës dëgjimore, rezultoi se atë ditë aktiviteti sportiv është anuluar dhe personeli mësimor (drejtorja e shkollës dhe mësueset kujdestare të të dy nxënësve) nuk kanë qenë në dijeni të këtij fakti. Mësueset kujdestare deklaruan se znj. S.S kishte kërkuar leje për vajzën që të ndiqte aktivitetin sportiv të të vëllait dhe mësuesja

kujdestare e djalit ka marrë të mirëqenë se V.S do të merrte pjesë në këtë aktivitet sportiv dhe kanë dhënë leje për të dy nxënësit.

Lidhur me dokumentacionin dhe procedurën e ndjekur për kryerjen e procesit të zgjedhjes së qeverisë së nxënësve të vitit shkollor 2021-2022 dhe dokumentacionin për lejen dhe anulimin e aktivitetit sportiv, shkolla “Andon Xoxa”, nuk depozitoi asnjë provë shkresore të kryerjes së procesit të zgjedhjes së qeverisë së nxënësve, por informoi se dokumentacioni ruhet nga ana e koordinatores vetëm për një vit mësimor, por nuk referoi asnjë bazë ligjore për të përligjur këtë veprim, si dhe nuk depozitoi asnjë dokumentacion për organizimin, lejen, anulimin dhe zhvillimin e aktivitetit sportiv të datës 04.05.2022.

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: “1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar; b); c).....”.

Në nenin 62 të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “Të drejtat dhe detyrat e prindërve: 2. Prindi ka të drejtë: c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;”.

Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar Rregulloren për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Në Rregulloren e sipërcituar parashikohet si më poshtë:

“Neni 42; 1. Drejtori i institucionit arsimor është titullari i institucionit, që ka të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. 2..... 3. Drejtori ka përgjegjësinë për zbatimin në institucionin arsimor të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi”;

Neni 66; 3. Mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht për: ç) ndjekjen e shkollës nga të gjithë nxënësit;

Neni 67; Bashkëpunimi i mësuesit kujdestar me prindërit: 2. Mësuesi kujdestar ka për detyrë: a) të informojë rregullisht personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore rreth mbarëvajtjes së fëmijëve të tyre;

Neni 77; 1. Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekesor, ose nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për arsye të jashtëzakonshme, ose kur ka kërkuar leje paraprakisht me një shënim sqarues dhe i është miratuar kërkesa nga mësuesi kujdestar. 2. Mësuesi kujdestar ka të drejtë të vlerësojë si të arsyetuara/të paarsyetuara mungesa deri në tri ditë mësimi gjatë një muaji;

Neni 88; *Të drejtat dhe detyrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore* 2. *Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka të drejtë të informohet nga institucioni arsimor për: d) veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese e jashtëshkollore dhe ekskursionet që organizon shkolla. 4. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka për detyrë: b) të njoftojë mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij. ... ç) të njoftojë mësuesin kujdestar në rastet kur fëmija i tij mungon dhe t'i arsyetojë këto mungesa;*”.

Organizimi dhe funksionimi i qeverisë së nxënësve rregullohet sipas Udhëzimit nr. 25, datë 02.08.2013, i ndryshuar.

Në Kreun 2, nënkreu I të këtij udhëzimi parashikohet se: *“2. Zgjedhjet për qeverinë e nxënësve bëhen në fillim të çdo viti mësimor. ... 6. Për shkollën bazë dhe për shkollën fillore kur është më vete, kryetari i qeverisë zgjidhet një anëtar i qeverisë, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të saj, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.... 9. Kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të përzgjidhet nga klasa 4-8 për arsimin bazë, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë nga klasa 10-11, për të fituar të drejtën të kandidojë në zgjedhjet e Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë”.*

Në nënkreun I/1 të kreut 2, përcaktohet se: *“3. Kryetari i qeverisë së nxënësve: f) shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës në rast të thyerjes së rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi”.*

Në nënkreun IV të kreut 2, parashikohet se: *“Mësuesi ndihmës. 1. Qeveria e nxënësve: a) përzgjedh mësuesin ndihmës, i cili e ndihmon në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë të saj dhe në veçanti, në hartimin e rregullores së qeverisë së nxënësve. 2. Drejtori i shkollës emëron mësuesin ndihmës. 3. Mësuesit ndihmës nuk i jepet klasë në kujdestari, me përjashtim të rasteve kur në shkollë ekzistojnë klasa pa mësues kujdestar”.*

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar, rezulton se Drejtori i shkollës si titullari i institucionit dhe koordinatori i qeverisë së nxënësve, janë personat përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se S.S me shkresën datë 11.05.2022 të dërguar nëpërmjet shërbimit postar, me e-mail-et datë 27.05.2022 dhe datë 27.06.2022, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar nga shkolla “Andon Xoxa”, informacion mbi procedurën e ndjekur për zgjedhjen dhe shkarkimin nga detyra e kryesëtorit, të djalit të tij dhe procesverbalin e mbajtur për shkarkimin e tij. Por nga ana e shkollës nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument shkresor mbi procesin e zhvilluar dhe as arsyen e shkarkimit të V.S nga detyra e kryetarit të qeverisë së nxënësve. Në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 203/1, datë 24.05.2022, shkolla “Andon Xoxa” ka informuar S.S, se V.S është zgjedhur në qeverinë e nxënësve dhe se ka marrë pjesë në takimet e zhvilluara, por nuk e ka informuar lidhur me arsyen e shkarkimit të tij dhe nuk i ka dërguar kopje të dokumentit (procesverbalit) të shkarkimit të djalit të tij.

Lidhur me mosvënien në dispozicion të Komisionerit të dokumenteve të procedurës së procesit të zgjedhjes së qeverisë së nxënësve, të vitit shkollor 2021-2022, me arsyen se dokumentacioni ruhet 1 vit, rezulton se nuk ka një dokument ligjor që të përligjë veprimin e shkollës, mbi mosruajtjen e këtij dokumentacioni, për më tepër që ky dokumentacion është kërkuar në mënyrë të përsëritur nga S.S, gjatë muajit maj-qershor 2022 (brenda vitit shkollor) dhe nuk i është vënë në dispozicion.

Gjithashtu, referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se shkolla “Andon Xoxa”, nuk dispononte dokumentacion për aktivitetin sportiv të datës 04.05.2022 dhe mësueset kujdestare nuk kishin dijeni për këtë aktivitet nëse do zhvillohej, ishte anuluar apo jo, gjë që solli dhe moskryerjen e detyrës nga mësuesi kujdestar i nxënësit V.S, për të komunikuar në kohë me prindin dhe për ta vënë në dijeni të mungesës së nxënësit gjatë procesit mësimor.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, drejtorja e shkollës “Andon Xoxa”, në cilësinë e titullarit të institucionit, nuk ka arritur të dokumentojë dhe justifikojë sipas dispozitave ligjore të sipërcituara, përgjegjësitë e saj lidhur me zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ligji për shkarkimin e kryetarit të qeverisë së nxënësve (Udhëzimi 25/2013, i ndryshuar, Kreu 2, nënkreu I/1), dokumentimin e aktivitetit sportiv të datës 04.05.2022 dhe të informimit/njoftimit të personelit mësimor për zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë që mësuesja kujdestare të lajmëronte në kohë prindin e nxënësit V.S për largimin e tij nga procesi mësimor.

Justifikimi i drejtores së shkollës “Andon Xoxa”, se koordinatorja e qeverisë së nxënësve ka njoftuar nxënësin V.S për shkarkimin nga pozicioni i kryetarit dhe se aktiviteti sportiv është anuluar, është i pambështetur në fakte dhe prova, por ngelet në kuadër të deklarimeve të saj.

Në këtë kontekst, Komisioneri, në mungesë të dokumentimit të deklarimeve të shkollës “Andon Xoxa”, mungesën e dokumentimit të fakteve të pretenduara për respektimin e procedurës së zhvillimit të zgjedhjeve të qeverisë së nxënësve dhe të anulimit të aktivitetit sportiv, e vlerëson si argument pro pretendimeve të ankuesit.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Drejtores së Shkollës “Andon Xoxa” Fier, kundrejt V.S, Komisioneri vlerëson se ai është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e shkollës “Andon Xoxa”.

- *Lidhur me pretendimin se V dhe M.S, nuk i janë vënë në dispozicion testet origjinale, fletëshpërngulja e V.S ka qenë e pavlefshme dhe mosregjistrimit të V.S në listën e provimit të lirim.*

Në nenin 20, pika 5 të Rregullores së Funkcionimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, përcaktohet se:

“5. Mësuesi mban të dhëna gjatë gjithë vitit shkollor për vlerësimin e nxënësit. Vlerësimi i vazhduar, testet/detyrat përmbledhëse dhe portofoli i nxënësit ruhen në shkollë dhe janë objekt monitorimi në çdo periudhë të vitit shkollor”. Referuar pikës 21 të nenit 3 të Rregullores përcaktohet se: “Viti shkollor është periudha nga data e fillimit të mësimeve deri në datën e mbarimit të provimeve të sesionit të dytë (provime kombëtare dhe klase)”.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ankuesi me e-mail-in datë 17.06.2022 dhe datë 28.06.2022, drejtuar shkollës “Andon Xoxa” ka kërkuar testet/detyrat përmbledhëse origjinale të fëmijëve të tij, V dhe M.S.

Shkolla “Andon Xoxa” me shkresën nr. 206/1, datë 24.05.2022, i ka vënë në dispozicion ankuesit portofolin dhe testet e periudhës së parë dhe të dytë të nxënësit V.S.

Në përgjigje të kërkesës së ankuesit, shkolla me e-mail-in datë 28.06.2022, ka njoftuar ankuesin se testet dhe detyrat përmbledhëse për të tria periudhat për nxënësen M.S, mund ti tërhiqte pranë shkollës, ndërsa për testet e nxënësit V.S, ankuesi në e-mail-in datë 28.06.2022 ka pranuar se shkolla i ka dërguar pjesërisht testet/detyrat përmbledhëse.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se testet/detyrat përmbledhëse të nxënësve ruhen në shkollë deri në përfundim të vitit shkollor, pra deri në përfundim të provimeve të sesionit të dytë, që përkon me dhjetëditëshin e parë të muajit shtator 2022 dhe në këtë rast shkolla duhet të ketë në dispozicion testet/detyrat përmbledhëse origjinale dhe nuk mund ti japë ato të interesuarve.

Lidhur me fletëshpërnguljen e nxënësit V.S, rezulton se shkolla “Andon Xoxa” në datë 09.05.2022 ka plotësuar dokumentin për shpërnguljen e nxënësit drejt një shkolle jopublike, në të cilin ka vendosur emërtimin: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Shkolla “Andon Xoxa” me shkresën nr. 888/1, datë 11.05.2022 ka njoftuar S.S se për shkak të një gabimi material (duhet MAS dhe jo MASR) ka shfuqizuar fletëshpërnguljen datë 09.05.2022, e cila nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik dhe ka dërguar fletëshpërnguljen datë 11.05.2022 e cila ka qenë e vlefshme për të regjistruar nxënësin në shkollën pritëse.

Lidhur me mosregjistrimin e emrit të nxënësit V.S në provimin e lirimit të datës 20.06.2022. Referuar fletëpranimit datë 09.05.2023 të shkollës jopublike “F.D”, rezulton se nxënësi V.S nga data 09.05.2022, është pranuar si nxënës i kësaj shkolle dhe si rezultat i këtij transferimi dhe emri i tij nuk mund të figuronte në listat e nxënësve të shkollës “Andon Xoxa”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Shkolla “Andon Xoxa” ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se V dhe M.S nuk i janë nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm nga ana e shkollës.

Në konkluzion, Komisioneri vlerëson se nxënësja M.S nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e shkollës “Andon Xoxa” Fier. Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri në vazhdim do trajtojë pretendimin për diskriminim, vetëm për nxënësin V.S.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën objekt shqyrtimi, S.S si përfaqësues i V.S pretendon se djali i tij është diskriminuar për shkak të bindjes së tij politike⁸, për shkak të përkatësisë prindërore⁹ të fëmijës të tij dhe për çdo shkak tjetër¹⁰.

Mbështetur në nenin 2¹¹, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B.1 Në lidhje me shkakun e bindjeve politike të S.S, Komisioneri gjykon se bindja politike konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë dhe ankuesi e ka dokumentuar atë, referuar Vërtetimin nr. 15, datë 18.05.2022, të lëshuar nga Partia Republikane, Dega Fier.

B.2 Në lidhje me shkakun e përkatësisë prindërore, Komisioneri gjykon se konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë dhe V.S e ka dokumentuar atë, referuar certifikatës familjare në të cilën rezulton se V.S është djali i S.S.

B.3 Në lidhje me “çdo shkak tjetër”.

Gjatë parashtrimeve, S.S ka pretenduar diskriminim të djalit të tij, për “çdo shkak tjetër”, duke argumentuar se trajtimi i pafavorshëm ndaj djalit të tij ka qënë për shkak të ankesës që S.S ka bërë

⁸ Referuar kopjes së Kartës së Anëtarësisë nr. 5-993 të lëshuar nga Partia Republikane e Shqipërisë, Dega Fier, rezulton se ankuesi S.S është pranuar si anëtar i këtij subjekti politik në datën 10.10.1995. Referuar Vërtetimin nr. 15, datë 18.05.2022, të lëshuar nga Partia Republikane, Dega Fier, rezulton që ankuesi S.S është anëtar i kësaj force politike dhe aktivist i këtij subjekti.

⁹ Referuar certifikatës familjare të lëshuar nga Njësia Administrative Cakran, datë 17.11.2020, rezulton se S.S është babai i dy fëmijëve: V.S dhe M.S.

¹⁰ Për shkak të ankesës së bërë pranë KMD-së në datë 22.11.2021, kundër Bashkisë Fier.

¹¹ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

pranë KMD-së në datë 22.11.2021, kundër Bashkisë Fier, duke e lidhur me faktin se nëndrejtoresha e shkollës “Andon Xoxa” është bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹³.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bëjnë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturat të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “staturat të tjera”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri¹⁴. Gjykata ka theksuar se fjalës “shkak/status tjetër” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë¹⁵. Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”¹⁶.

¹² Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

¹³ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

¹⁴ Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të tjerë kundër Rusisë, prg. 90.

¹⁵ Shiko: Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 70.

¹⁶ Shiko: Biao kundër Danimarkës, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “statuseve të tjera” janë: Në Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në gradën ushtarake mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në Larkos kundër Qipros, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër; në Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata konsideroi se të qenit i burgosur mund të binte në nocionin e "statusit tjetër" sipas nenit 14; në Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “statusit tjetër”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se statusi si ish oficer i KGB-së përfshihet në nenin 14; në Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimit të parakohshëm bazuar në kohëzgjatjen e dënimit me burg.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Komisioneri vlerëson se, pretendimi “për çdo shkak tjetër” qëndron dhe është i provuar, bazuar në provat e depozituara në dosje. Konstatohet se nëndrejtoreshë e shkollës “Andon Xoxa”, është bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier dhe S.S ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 219, datë 22.11.2021, kundër Bashkisë Fier në të cilën ka pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, Komisioneri vlerëson si shkaqe të mbrojtura nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër”¹⁷.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me shkaqet e mbrojtura.

Për të vërtetuar faktin, se V.S është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e shkollës “Andon Xoxa”, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të V.S.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.*

¹⁷ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 151, datë 11.08.2021 dhe Vendimin nr. 170, datë 28.08.2023 të KMD-së.

Ky parim përshkon edhe nenin 48 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh. Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Sipas nenit 5/1 të LMD-së, “*ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë*”.

Në bazë të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlegjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁸.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku

¹⁸ Çështja *Abdulaziz, Cabales and Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aplikimi nr. 9214/80; 473/81; 9474/81); Çështja *Fabián kundër Hungarisë* (Aplikimi nr. 78117/13); Çështja *Molla Sali kundër Greqisë* (Aplikimi nr. 20452/14).

sanksionohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁹

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës “*praesumptio iuris tantum*”.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të V.S, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se V.S i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për t’u njojtur me aktin e shkarkimit nga pozicioni i kryetarit të qeverisë së nxënësve dhe prindërit për t’u njoftuar në kohë për largimit e djalit të tyre nga procesi mësimor. *Së dyti*, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i V.S, nga ana e shkollës, lidhet me shkaqet e mbrojtura dhe ka ardhur pikërisht prej tyre.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provohet se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi, dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Është e domosdoshme që *prima facie*, faktet dhe provat e administruara të krijojnë prezumimin e diskriminimit, pra që bindja politike e S.S dhe ankesa e bërë nga S.S pranë Komisionerit në datë 22.11.2021, kundër Bashkisë Fier dhe veprimeve të nëndrejtoreshës së shkollës që është bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier, duke u lidhur me faktin që V.S është djali i S.S, janë i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm, të cilit i është nënshtruar nxënësi V.S. Vetëm kur arrihet ky nivel bindje, barra e provës për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm nuk përbën diskriminim, mund t’i kalojë shkollës.

Bazuar në konkluzionet e pjesës A, të Vendimit, Komisioneri vlerësoi se, drejtorja e shkollës “Andon Xoxa”, në cilësinë e titullarit të institucionit, nuk ka arritur të dokumentojë dhe justifikojë sipas dispozitave ligjore të sipërcituara, përgjegjësitë e saj lidhur me zbatimin e detyrave të ngarkuara nga ligji për shkarkimin e kryetarit të qeverisë së nxënësve (Udhëzimi 25/2013, i ndryshuar, Kreu 2, nënkreu I/1), dokumentimin e aktivitetit sportiv të datës 04.05.2022 dhe të

¹⁹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

informimit/njoftimit të personelit mësimor për zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë që mësuesja kujdestare të lajmëronin në kohë prindin e nxënësit V.S për largimin e tij nga procesi mësimor.

Por, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, S.S në cilësinë e prindit të nxënësit V.S, nuk arriti të provojë se shkaqet e pretenduara, kanë shërbyer si shkaqe për të cilin nxënësi V.S është diskriminuar nga ana e shkollës.

- Në analizë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, nuk u administrua asnjë provë që të tregonte se drejtuesja e shkollës në cilësinë e titullares së institucionit kishte dijeni, qoftë dhe në mënyrë të tërthortë, për bindjet dhe angazhimin politik të babait të nxënësit V.S.
- Rezulton se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vënë në dijeni Bashkinë Fier, lidhur me ankesën nr. 219, datë 22.11.2021 të S.S, në datë 06.12.2021, ndërkohë që shkarkimi i V.S nga kryetar i qeverisë së nxënësve është bërë në muajin nëntor 2021.
- Gjithashtu, Komisioneri nuk disponon fakte dhe as prova rrethore se nëndrejtoresha e shkollës, që është bashkëshortja e Kryetarit të Bashkisë Fier, të ketë ndikuar tek drejtuesja e shkollës apo tek personeli mësimor për shkarkimin e V.S nga kryetar i qeverisë së nxënësve, për më tepër që nxënësi nuk duhet të ishte zgjedhur pasi ishte nxënës i klasës së 9-të dhe kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të ishte nxënës i klasës 4-8-të.
- Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, bindja politike dhe përgjegjësia prindërore e babait të V.S dhe ankesa e bërë nga S.S pranë Komisionerit kundër Bashkisë Fier në datë 18.11.2021, nuk kanë shërbyer si shkaqe për trajtimin e padrejtë e të pafavorshëm të nxënësit V.S, nga ana e shkollës “Andon Xoxa”.

Duke u bazuar në standartin e provueshmërisë të parashikuar nga neni 82/2 i K.Pr.Administrative, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit të konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj nxënësit V.S dhe ekzistencës së shkaqeve të mbrojtura, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar nxënësi V.S është si rezultat i posedimit të këtyre shkaqeve dhe se në mungesë të tyre V.S do të ishte trajtuar ndryshe. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t’u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se shpjegimi i vetëm i arsyeshëm për mosnxjerrjen e aktit të shkarkimit të nxënësit V.S nga pozicioni i kryetarit të qeverisë së nxënësve dhe mosnjoftimi në kohë i prindit të nxënësit V.S për largimin e djalit të tij nga procesi mësimor është bindja politike dhe përgjegjësia prindërore e babait të V.S dhe ankesa e S.S e bërë pranë KMD-së kundër Bashkisë Fier.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shkolla “Andon Xoxa” nuk e ka diskriminuar nxënësin V.S, për shkak të bindjes politike dhe përgjegjësisë prindërore të babait të nxënësit V.S dhe për shkak të ankesës së bërë nga S.S pranë KMD-së kundër Bashkisë Fier. Për rrjedhojë

shkolla “Andon Xoxa” nuk ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve V.S dhe M.S nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Andon Xoxa”, Fier.
2. Mospranimin e ankesës së S.S kundër Bashkisë Fier, pasi është marrë një vendim i mëparshëm nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA